

**VENDIM****Nr. 218, datë 11.3.2015****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE,  
PROCEDURAVE DHE RREGULLAVE  
PËR SHFRYTËZIMIN, NË SIPËRFAQE  
DHE NËNTOKË, TË ZONAVE QË JANË  
NGJITUR ME LEJET EKZISTUESE DHE  
NDRYSHIMIN E KOORDINATAVE PËR  
LEJET MINERARE TË PËRCAKTUARA  
NË HAPËSIRË ME TRI KOORDINATA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 1, dhe 57, pika 2/1, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Procedurat, kriteret dhe rregullat për shfrytëzimin, në sipërfaqe dhe nëntokë, të zonave që janë ngjitur me lejet ekzistuese

1. Subjektet e licencuara me leje shfrytëzimi mund të kërkojnë një sipërfaqe shtesë, ngjitur me konturet e lejes ekzistuese, në një nga rastet, kur:

a) janë në përfundim të rezervave në zonën e lejuar;

b) shprehin interesin e veçantë në përmirësimin e parametrave teknologjikë dhe treguesve të prodhimit;

c) në rast se u lind nevoja për kryerjen e punimeve kapitale, që shërbejnë për zhvillimin e minierës në thellësi.

2. Kërkesa e subjektit shqyrtohet në rast se sipërfaqja e kërkuar është e lirë dhe subjekti ka zbatuar, në mënyrë korrekte, dispozitat ligjore për lejen/lejet ekzistuese. Në çdo rast, sipërfaqja e kërkuar nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e lejes ekzistuese të subjektit.

3. Ministria shqyrton, paraprakisht, kërkesën dhe njofton subjektin brenda 45 ditëve nga data e marrjes së saj. Në rast të pranimit të kërkesës nga ministria, subjekti duhet të aplikojë pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit, me një projekt të plotë tekniko-ekonomik, ku përfshihet zona e lejes ekzistuese dhe shtesa, brenda 30 ditëve nga marrja e lejes së mjedisit, për shtesën përkatëse, të lëshuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Projekti tekniko-ekonomik shqyrtohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për të cilin këshilli teknik i saj vendos brenda 45 ditëve nga data e aplikimit në Qendrën Kombëtare të Licencimit.

5. Ministri nënshkruan “Aktin e miratimit të lejes”, brenda 90 ditëve nga data fillestare e aplikimit të subjektit në Qendrën Kombëtare të Licencimit.

6. Afati i vlefshmërisë së lejes, për shfrytëzimin, në sipërfaqe dhe nëntokë, të zonave që janë ngjitur me lejen ekzistuese, do të jetë periudha e mbetur deri në afatin maksimal të lejes ekzistuese, duke përfshirë edhe zgjatjen e mundshme 10-vjeçare të saj.

7. Në “Aktin e miratimit” përcaktohet niveli i prodhimit, vlera e investimeve dhe garancia financiare e tyre, vlera e rehabilitimit të mjedisit dhe garancia financiare vjetore e mjedisit.

8. Subjekti dorëzon në QKL garancinë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit dhe garancinë financiare të investimeve jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të “Aktit të miratimit” të lejes së ndryshuar nga ministri.

9. Prodhimi, për sipërfaqen shtesë, duhet të llogaritet deri në afatin maksimal të lejes, përfshirë edhe zgjatjen 10-vjeçare të saj. Në zonën shtesë duhet të garantohet kryerja e punimeve kapitale dhe funksionimi normal i tyre gjatë vazhdimit të shfrytëzimit në thellësi të minierës, për kohën e vlefshmërisë së lejes.

10. Subjektet që, aktualisht, janë lejuar të shfrytëzojnë në sipërfaqe dhe nëntokë të zonave që janë ngjitur me lejet e tyre ekzistuese, janë të detyruara të riaplikojnë, sipas këtij vendimi, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e tij, duke plotësuar kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2. Subjekteve që nuk kanë aplikuar brenda afatit, ose që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, u revokohen lejet për shfrytëzimin, në sipërfaqe dhe nëntokë, të zonave që janë ngjitur me lejet e tyre ekzistuese.

II. Përcaktimi i procedurave, kriterëve dhe rregullave për ndryshimin e koordinatave për lejet minerare, të përcaktuara në hapësirë me tri koordinata

1. Subjektet me leje minerare, kufijtë e të cilave janë dhënë në hapësirë me tri koordinata, në bazë të ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994, “Ligji



minerar i Shqipërisë”, i ndryshuar, mund të bëjnë kërkesë për ndryshim të koordinatave të zonës së lejuar. Ministria shqyrton, paraprakisht, kërkesën, në rast se subjekti kërkues ka zbatuar, në mënyrë korrekte, dispozitat ligjore për lejet ekzistuese.

2. Kërkesa duhet të jetë teknikisht e mundshme, të mos mbivendoset me lejet e dhëna më parë si dhe të garantojë sigurinë në punë.

3. Kërkesa për ndryshim të koordinatave mund të bëhet për shkaqe, si më poshtë:

a) për shkaqe gjeologjike;

b) kur vërtetohet se vazhdimësia e trupit është jashtë zonës së lejuar;

c) kur, nga pikëpamja teknologjike, është e nevojshme që shfrytëzimi të vazhdojë nga punimet e zhvilluara në zonën për të cilën është dhënë leja ekzistuese;

ç) kur hapja e punimeve kapitale është e nevojshme për të shmangur zonat e rrezikshme.

4. Ndryshimi i koordinatave është i mundshëm kur zona e ndryshuar është e kufizuar në planin vertikal nga dy plane horizontale, ku dyshemeja është e kufizuar nga plani horizontal, që ka si kuotë, kuotën maksimale të dyshemesë së lejes ekzistuese dhe për tavan, kuotën minimale të tavanit të saj.

5. Realizimi i ndryshimit të koordinatave të bëhet, si më poshtë:

a) të hiqet kuota e tavanit, kur mbi sipërfaqen totale të zonës së ndryshuar të lejes nuk ka mbivendosje me një leje tjetër dhe zona e zgjeruar përfshin panelin deri në sipërfaqe;

b) të hiqet kuota e dyshemesë, kur nuk ka leje poshtë saj, për gjithë zonën e lejuar të ndryshuar.

6. Subjekti, i cili ka takuar trupin mineral në horizontet e sipërme dhe, për efekt të këndit të rënies ose tektonikës, trupi mineral zhvillohet jashtë zonës së lejuar të këtij subjekti, ka përparësi në kërkesën për ndryshim koordinatash ndaj një subjekti tjetër, i cili ka lejen minerare në të njëjtën kuotë me këtë subjekt.

7. Ministria shqyrton, paraprakisht, kërkesën dhe njofton subjektin brenda 45 ditëve nga data e marrjes së saj.

8. Në rast të pranimit të kërkesës nga ministria, subjekti duhet të aplikojë pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit me një projekt të plotë tekniko-ekonomik, ku të përfshihet edhe ndryshimi i koordinatave, brenda 30 ditëve nga marrja e lejes së mjedisit, për shtesën përkatëse,

të lëshuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Projekti i plotë tekniko-ekonomik, shqyrtohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për të cilin këshilli teknik i saj vendos, brenda 45 ditëve nga data e aplikimit në Qendrën Kombëtare të Licencimit.

10. Ministri nënshkruan “Aktit e miratimit” të lejes brenda 90 ditëve nga data fillestare e aplikimit të subjektit në Qendrën Kombëtare të Licencimit.

11. Subjekti dorëzon në QKL garancinë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit dhe garancinë financiare të investimeve, jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të “Aktit të miratimit” të lejes së ndryshuar nga ministri.

III. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Në rastin kur një e drejtë minerare është miratuar me marrëveshje koncesionare, nuk zbatohen kriteret, rregullat dhe procedurat, sipas këtij vendimi. Miratimi dhe ndryshimi i koordinatave të lejes përkatëse të shfrytëzimit bëhet sipas kriterëve, rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 571, datë 27.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të lejuara minerare për të drejtat minerare të miratuara me marrëveshje koncesionare”.

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Qendra Kombëtare e Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**



## VENDIM

Nr. 219, datë 11.3.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE E TË PROCEDURAVE PËR KONSULTIMIN ME GRUPET E INTERESIT DHE PUBLIKUN, SI DHE DËGJESËN PUBLIKE GJATË PROCESIT TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR\***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 10, të ligjit nr. 91/2013, datë 28.2.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për informimin, përfshirjen dhe konsultimin me publikun dhe grupet e interesit gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor (VSM).

2. Për qëllim të këtij vendimi, do të zbatohen përkufizimet përkatëse të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 91/2013, datë 28.2.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.

I. NJOFTIMI DHE KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR HARTIMIN, NDRYSHIMIN, RISHIKIMIN OSE MODIFIKIMIN E NJË PLANI APO PROGRAMI

1. Ministria, brenda 7(shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga autoriteti propozues për hartimin, ndryshimin, rishikimin ose modifikimin e një plani apo programi, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 91/2013, datë 28.2.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, e dërgon propozimin në formë elektronike për mendim të grupet e interesit, të përcaktuara në shkronjën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 91/2013, dhe i njofton ato për datën, orën dhe vendin e organizimit të takimit, siç përcaktohet në vijim të këtij kreu.

2. Autoriteti propozues, në bashkëpunim me ministrinë, organizon takimin e thërret për pjesëmarrje grupet e interesit të përcaktuara në shkronjën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

3. Shpenzimet për organizimin e takimit mbulohen nga autoriteti propozues.

4. Grupet e interesit ia dërgojnë mendimin e tyre me shkrim ministrisë, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e takimit, për nevojën ose jo të kryerjes së procesit të VSM-së për hartimin, rishikimin, ndryshimin apo modifikimin e planit ose programit të propozuar dhe, nëse ato nuk shprehen brenda afatit ligjor, nënkuptohet se nuk kanë kërkesa për propozimin.

5. Ministria, brenda 30(tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, vendos nëse hartimi, rishikimi, ndryshimi apo modifikimi i planit ose programit duhet t'i nënshtrohet procesit të VSM-së dhe i dërgon autoritetit propozues vendimin e saj duke i bashkëlidhur edhe sqarimet e kërkesat, sipas pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.

6. Ministria, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit, e publikon atë në faqen e vet zyrtare të internetit, ndërsa një kopje i dërgohet AKPT-së, në formë shkresore, dhe grupeve të interesit të konsultuara sipas pikës 2 të këtij vendimi, në formë elektronike.

II. KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR ÇËSHTJET QË DO TË TRAJTOHEN NË RAPORTIN E VSM-SË

1. Për konsultimin e grupeve të interesit për çështjet që duan të trajtohen në raportin e VSM-së, autoriteti propozues u dërgon një njoftim në formë shkresore dhe elektronike grupeve të interesit të përcaktuara në pikën 1, të nenit 9, të ligjit nr. 91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, ku përcaktohen data, ora dhe vendi i organizimit të takimit.

2. Në njoftim përcaktohen gjithashtu:

a) qëllimi i propozimit, shoqëruar me të dhëna të tjera të nevojshme, si: relacion shpjegues, hartat e të dhëna të tjera ndihmëse që disponon autoriteti lidhur me propozimin;

b) arsyetimi për nevojën e hartimit, ndryshimit, rishikimit ose modifikimit të planit apo programit;

c) autoriteti miratues i planit apo programit;

\* Ky vendim është përafshuar pjesërisht me: direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001, “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”, Numri CELEX: 32001L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.197, datë 21.7.2001, faqe 30 - 37.



ç) procedura që do të zbatohet për hartimin, ndryshimin, rishikimin apo modifikimin e planit ose programit, si dhe afatet kohore të parashikuara për këtë.

3. Autoriteti propozues organizon takimin me grupet e interesit, ku prezantohet në mënyrë të përmbledhur plani apo programi i propozuar, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dërgimit të njoftimit.

4. Grupet e interesit i përgjigjen autoritetit propozues brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e takimit. Në rast se ato nuk përgjigjen brenda këtij afati, atëherë nënkuptohet se nuk kanë kërkesa të veçanta për t'u trajtuar në raportin paraprak të VSM-së, përveç atyre të përcaktuara në pikën 3, të nenit 10, të ligjit nr. 91/2013, datë 28.2.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor".

5. Nëse grupet e interesit kanë kërkesa apo sugjerime për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e VSM-së, ato merren në konsideratë nga autoriteti propozues gjatë hartimit të raportit paraprak dhe përfundimtar të këtij raporti ose argumentohet mosmarrja parasysh e tyre.

6. Gjatë organizimit të takimit, autoriteti propozues i dërgon njoftim ministrisë për pjesëmarrje.

### III. KONSULTIMI I RAPORTIT PARAPRAK TË VSM-SË ME PUBLIKUN DHE GRUPET E INTERESIT

1. Autoriteti propozues, pas hartimit të raportit paraprak të VSM-së, e publikon atë për të paktën 30 (tridhjetë) ditë në faqen zyrtare elektronike.

2. Pas publikimit të raportit paraprak të VSM-së, sipas pikës 1 të këtij kreu, autoriteti propozues njofton ministrinë dhe grupet e interesit të konsultuara sipas pikës 1, të kreut I të këtij vendimi, duke i sqaruar mënyrën për t'u njohur me raportin, si dhe datën kur do të organizohet dëgjesa publike.

3. Autoriteti propozues e publikon njoftimin e përcaktuar në pikën 2 të këtij kreu, edhe në të paktën një media audiovizive ose të shkruar lokale dhe kombëtare.

4. Dëgjesa publike organizohet nga autoriteti propozues, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të grupeve të interesit, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij kreu.

5. Grupet e konsultuara sipas pikës 2 të këtij kreu dhe publiku, shprehin mendimet e sugje-

rimet e tyre gjatë dëgjësës publike dhe gëzojnë të drejtën të dërgojnë me shkrim komente pranë autoritetit propozues, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e mbajtjes së dëgjësës publike.

6. Autoriteti propozues dokumenton procesin e konsultimit në raportin përfundimtar të VSM-së, në të cilin pasqyron reflektimin e mendimeve, komenteve e të sugjerimeve, si dhe argumenton mosmarrjen parasysh të mendimeve apo sugjerimeve të ngritura gjatë procesit të konsultimit.

7. Zhvillimi i konsultimit me grupet e interesit dhe publikun, për raportin paraprak të VSM-së, sipas përcaktimeve të këtij kreu, është kusht i domosdoshëm që ministria të marrë në shqyrtim dhe të miratojë deklaratën.

### IV. DËGJESA ME PUBLIKUN GJATË SHQYRTIMIT PËR DHËNIEN E DEKLARATËS

1. Ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për deklaratën, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 91/2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", në rast se e sheh të nevojshme që për dhënien e deklaratës të organizojë vetë një dëgjese me publikun, atëherë njofton autoritetin propozues, duke i argumentuar edhe nevojën për organizimin e dëgjësës publike dhe duke i përcaktuar kohën e vendin.

2. Ministria, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e njoftimit që i bën autoritetit propozues për dëgjësën publike, kryen këto veprime:

a) njofton me shkrim dhe në formë elektronike të gjitha grupet e interesit dhe publikun, për të cilat mendon se duhet të jenë të pranishme gjatë dëgjësës;

b) publikon në faqen e saj të internetit njoftimin për organizimin e dëgjësës publike dhe përmbledhjen joteknike të raportit përfundimtar të VSM-së;

c) afishon në hapësirën e informimit të publikut një kopje të njoftimit për dëgjësën publike.

3. Autoriteti propozues, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga ministria, kryen këto veprime:

a) njofton me shkrim dhe me e-mail grupet e interesit, të cilat janë konsultuar sipas përcaktimeve të kreut 2, të këtij vendimi, për organizimin e dëgjësës publike;

b) përgatit prezantimin e planit apo programit





që propozohet për t'u pajisur me deklaratë, i cili përmban të paktën qëllimin e propozimit, shoqëruar me të dhëna të tjera të nevojshme, si: hartat e të dhëna të tjera ndihmëse që disponon lidhur me propozimin, arsyetimin për nevojën e hartimit, ndryshimit, rishikimit ose modifikimit të planit apo programit, konsultimet e kryera deri në hartimin e raportit përfundimtar të VSM-së si dhe rezultatet e raportit përfundimtar të VSM-së;

c) u shpërndan kopje të prezantimit dhe përmbledhjes në gjuhë joteknike të raportit përfundimtar të VSM-së të pranishmëve në dëgjesën publike;

ç) njofton subjektin fizik/juridik që ka hartuar raportin e VSM-së që të marrë pjesë në dëgjesën publike;

d) publikon njoftimin për dëgjesën publike në të paktën një media audiovizive ose të shkruar lokale dhe kombëtare.

4. Përfaqësuesit e ministrisë mbajnë shënime në mënyrë të pavarur për diskutimet e plota të dëgjesës publike dhe i pasqyrojnë ato në një raport të posaçëm.

5. Në rast se gjatë dëgjesës publike janë shprehur mendime apo sugjerime të cilat duhet të reflektohen në raportin përfundimtar të VSM-së, ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve, ia dërgon ato autoritetit propozues për t'i reflektuar në raportin përfundimtar të VSM-së.

6. Autoriteti propozues, pas marrjes së komenteve dhe sugjerimeve nga ministria, i reflekton në raportin përfundimtar të VSM-së ose argumenton mosmarrjen parasysh të mendimeve apo sugjerimeve të ngritura gjatë dëgjesës dhe e dërgon raportin në ministri.

7. Ministria, pas marrjes së raportit të VSM-së, vijon procedurën për shqyrtimin dhe pajisjen me deklaratën e ministrit sipas përcaktimeve të nenit 12, të ligjit nr. 91/2013, datë 28.2.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor".

#### V. INFORMIMI GJATË MONITORIMIT DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Ministria, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së raportit sipas pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 91/2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", nga autoriteti propozues, i publikon të dhënat e monitorimit gjatë zbatimit të planit apo programit në faqen elektronike të saj.

2. Me kërkesë nga grupet e interesit dhe publiku, ministria u siguron kopje të shtypura të të dhënave të monitorimit të paraqitura nga autoriteti propozues.

3. Grupet e interesit dhe publiku mund të dërgojnë mendime dhe komente për të dhënat e monitorimit pranë ministrisë.

4. Çdo grup interesi dhe publiku kanë të drejtë të ankohen ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve gjatë zhvillimit të procedurës së informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin e VSM-së, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe autoriteti/et propozues/e dhe miratues/e të planeve apo programeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 2015.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

#### VENDIM

Nr. 220, datë 11.3.2015

### PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE KRITEREVE PËR PAJISJEN ME EKOETIKETË, MËNYRËN E PËRDORIMIT DHE VLEFSHMËRINË E SAJ, DHE PËRBËRJEN E FUNKSIONIMIT E KOMISIONIT PËR LËSHIMIN E EKOETIKETËS\*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

#### I. QËLLIMI DHE OBJEKTI

1. Produktet me ndikim negativ të reduktuar mjedisor gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor pajisen me ekoetiketë, sipas procedurave dhe kërkesave të përcaktuara në këtë vendim.

\* Ky vendim transponon pjesërisht rregulloren nr. 66/2010 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 nëntor 2009 për ekoetiketën BE, EUR-Lex - 2010R0066 – EN, Fletorja Zyrtare OJ L 27, 30.01.2010, p.1



2. Qëllimi i dhënies së ekoetiketës është promovimi i produkteve me ndikim më të reduktuar në mjedis, krahasuar me produkte të tjera ekuivalente, duke kontribuar, kështu, në përdorimin efikas të burimeve natyrore, për një nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit si dhe informimin e konsumatorëve për produkte të tilla.

3. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, ndërsa termat e mëposhtme kanë kuptimet, si më poshtë vijon:

a) “Grup produkti” nënkupton një grup produktesh të ngjashme në karakteristikat funksionale dhe kushtet e përdorimit ose që shërbejnë për qëllime të ngjashme dhe janë të ngjashme në kushtet e perceptimit nga ana e konsumatorit;

b) “Komisioni Shtetëror për Dhënien e Ekoetiketës”, më poshtë Komisioni, është organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave për pajisjen me ekoetiketë;

c) “Ndikim mjedisor” nënkupton çdo ndryshim ndaj mjedisit që vjen plotësisht ose pjesërisht si rezultat i një produkti gjatë ciklit të jetës së tij;

ç) “Operator” nënkupton çdo prodhues, fabrikues, importues, ofrues shërbimi, shitës me shumicë ose me pakicë;

d) “Performancë mjedisore” nënkupton rezultatën e menaxhimit, nga ana e prodhuesit, të karakteristikave të një produkti që ka ndikim në mjedis;

dh) “Produkt” nënkupton çdo mall që prodhohet, shpërndahet për konsum ose përdorim si dhe çdo shërbim që ofrohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

e) “Verifikim” nënkupton procedurën e vlerësimit nëse një produkt përmbush ose jo kriteret e specifikuar në këtë vendim për pajisjen me ekoetiketë.

4. Ekoetiketa jepet për produkte dhe grupin e produkteve të listuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ekoetiketa nuk jepet për:

a) produkte që përmbajnë substanca e preparate të klasifikuara si shumë toksike, toksike dhe të

rrezikshme për mjedisin, për riprodhimin ose mutagjene, kancerogjene, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) mallrat e prodhuara nga procese që dëmtojnë, mund të dëmtojnë ose mund të jenë të dëmshme, në mënyrë të konsiderueshme, për njeriun dhe/ose mjedisin.

## II.KRITERET

1. Kriteret për dhënien e ekoetiketës përfshijnë kërkesa për të siguruar që produktet që do të mbajnë ekoetiketën do të funksionojnë në përputhje me qëllimin e përdorimit të tyre, sipas standardeve të miratuara me legjislacion të posaçëm.

2. Kriteret për dhënien e ekoetiketës bazohen në performancën mjedisore të produkteve, duke marrë në konsideratë objektivat më të fundit strategjike në fushën e mjedisit. Këto kritere përcaktojnë kërkesat mjedisore që duhet të përmbushë një produkt për të mbajtur ekoetiketën.

3. Kriteret për dhënien e ekoetiketës bazohen në të dhëna shkencore, duke marrë në konsideratë gjithë ciklin e jetës së produktit. Në përcaktimin e këtyre kriterëve duhet të merren në konsideratë, si më poshtë vijon:

a) ndikimet më domethënëse mjedisore, në veçanti ato për ndryshimin e klimës, ndikimin në natyrë dhe biodiversitet, konsumi i energjisë dhe burimeve, gjenerimi i mbetjeve, emetimet në përbërësit natyrorë të mjedisit, ndotja, përmes efekteve fizike, dhe përdorimi e çlirimi i substancave të rrezikshme;

b) zëvendësimi i substancave të rrezikshme me substanca më të sigurta ose nëpërmjet përdorimit të materialeve apo projekteve alternative, kur është teknikisht e realizueshme;

c) potenciali për të reduktuar ndikimet mjedisore negative, lidhur me qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë ose ripërdorimin e produktit;

ç) balancën mjedisore neto, midis përfitimeve dhe humbjeve, në kontekstin mjedisor, duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë në faza të ndryshme të jetëgjatësisë së produktit;

d) ndikimi social dhe etik, referuar konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, që kanë lidhje me to, siç janë standardet përkatëse të Organizatës Botërore të Punës (ILO) dhe kodet e sjelljes;

dh) kriteret e përcaktuara për etiketa të tjera mjedisore ISO, të miratuara në nivel kombëtar



apo rajonal, kur ato ekzistojnë, për atë produkt apo grup produkti;

e) parimi i reduktimit të testimit të kafshët.

4. Kriteret për dhënien e ekoetiketës për çdo produkt dhe grup produkti, të listuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, miratohen me udhëzime të përbashkëta të ministrit përgjegjës për mjedisin, ministrit përgjegjës për shëndetësinë, ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ministrit përgjegjës për turizmin, sipas fushave të veprimtarisë.

### III. DHËNIA E EKOETIKETËS, TERMAT DHE KUSHTET E PËRDORIMIT TË SAJ

1. Operatori, që kërkon të pajisë produktin me ekoetiketë, depoziton kërkesën e tij në ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

2. Kërkesa, me shkrim, për pajisje me ekoetiketë, shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) të dhënat personale të operatorit, adresa, kontaktet;

b) emërtimin e produktit, për të cilin kërkohet ekoetiketa;

c) studimin për harmonizimin e produktit me kriteret e miratuara;

ç) mandatpagesën për tarifën.

3. Studimi për harmonizimin e produktit duhet të specifikojë të dhënat e plota dhe përshkrimin e detajuar për produktin apo grupin e produktit si dhe të gjitha informacionet e tjera të kërkuara, në përputhje me kriteret në fuqi për pajisjen me ekoetiketë.

4. Ministria, nëpërmjet sekretariatit, të ngritur sipas pikës 7 të këtij kreu, shqyrton dokumentacionin brenda 25 ditëve pune, nga data e marrjes së kërkesës.

5. Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, ministria i kërkon operatorit plotësimin e tij, brenda 30 ditëve pune. Në qoftë se operatori nuk e plotëson dokumentacionin brenda afatit të caktuar, kërkesa nuk do të konsiderohet e paraqitur.

6. Sekretariati kryen funksionet administrative të komisionit, regjistron kërkesat e paraqitura dhe njofton kryetarin e komisionit. Kryetari thërret komisionin, duke përcaktuar datën dhe orën e takimit, jo më vonë se 40 ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

7. Personi/at përgjegjës, me funksionin e sekretariatit të komisionit, është/janë nëpunës të

ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe emërohet/n me urdhër të ministrit.

8. Komisioni funksionon si organizëm ndërinstitucional, me përfaqësues nga ministritë, në nivel zëvendësministrash, nga institutet kërkimore-shkencore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, shoqatat mjedisore dhe grupet e interesit, dhe drejtohet nga zëvendësministri përgjegjës për mjedisin. Ngritja, përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit përcaktohen me urdhër të Kryeministrit. Mënyra dhe vlera e pagesës së anëtarëve të Komisionit, të cilët nuk janë përfaqësues të ministrive apo institucioneve të varësisë së tyre, përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mjedisit dhe përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për mjedisin.

9. Komisioni realizon procesin e verifikimit të studimit, në mënyrë të paanshme dhe të besueshme, për harmonizimin e produktit me kriteret, brenda 60 ditëve pune nga data e mbledhjes së komisionit për marrjen në shqyrtim të kërkesës.

10. Operatori paguan një tarifë shërbimi për marrjen e ekoetiketës dhe një tarifë shërbimi vjetor, të cilat përcaktohen me udhëzim të përbashkët të dhe ministrit të Financave. Të ardhurat nga këto tarifa derdhen në buxhetin e shtetit.

11. Nëse komisioni konstaton se produkti i plotëson kriteret e përcaktuara në udhëzim, referuar pikës 4, të kreu II, të këtij vendimi, për pajisjen me ekoetiketë, i propozon ministrit dhënien e ekoetiketës.

12. Ekoetiketa jepet për një periudhë jo më të gjatë se 5 (pesë) vjet.

13. Nëse komisioni konstaton se produkti nuk i plotëson kriteret, ai propozon që studimi, i përmendur në shkronjën “c”, të pikës 2, të këtij kreu, të rishikohet dhe plotësohet brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh.

14. Komunikimi mes komisionit dhe operatorit realizohet nëpërmjet sekretariatit.

15. Operatori gëzon të drejtën e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale.

16. Format i ekoetiketës, logos, sipas produktit apo grupproduktit, numri i regjistrimit dhe mënyra e përdorimit të logos miratohen me udhëzim të ministrit.

17. Ministria krijon regjistrin e ekoetiketave të



dhëna, duke vendosur numrin e regjistrimit për secilin produkt, që miratohet me urdhër të ministrit, dhe i publikon ato në faqen e saj elektronike.

18. Etiketimi përdoret vetëm për produktin që përputhet me kriteret e ekoetiketit, të zbatueshme për produktin në fjalë dhe për të cilat është dhënë ekoetiketa.

19. Operatori përballon, me shpenzimet e veta, kostot e testimit dhe vlerësimit të konformitetit me kriteret e ekoetiketit.

20. Kur kriteret e ekoetiketit kërkojnë që fabrikat e prodhimit të përmbushin disa kërkesa, ato duhet të përmbushen nga të gjitha fabrikat në të cilat prodhohen produktet që mbajnë ekoetiketën.

21. Komisioni pranon rezultatet e kryerjes së testeve për produktet vetëm nga laboratorë të certifikuar dhe akredituar, sipas legjislacionit në fuqi. Komisioni mund të kërkojë kryerjen e testeve të tjera apo ritestim për produktet, kostot e të cilave përballohen nga operatori.

22. Operatori mund të vendosë ekoetiketën në produkt vetëm pas miratimit nga ministri. Operatori duhet të vendosë, gjithashtu, numrin e regjistrimit, në produktin që mban ekoetiketën, sipas formatit të referuar në pikën 16, më lart.

23. Komisioni, kryesisht ose nëpërmjet sekretariatit:

a) verifikon, periodikisht, përputhshmërinë e produktit me kriteret dhe kushtet e ekoetiketës, gjatë afatit të vlefshmërisë së saj;

b) njofton operatorin për çdo ankesë të bërë, në lidhje me produktin që mban ekoetiketën, duke ruajtur anonimatën e ankuesit;

c) ka të drejtë të hyjë në ambientet në të cilat prodhohet ose ofrohet produkti.

24. Ministri, me propozim të komisionit, mund ta heqë ekoetiketën, kur operatori nuk vepron në përputhje me kriteret dhe kushtet, në bazë të të cilave është dhënë ekoetiketa ose nuk i përmbush më kriteret e përcaktuara për pajisjen me ekoetiketë.

25. Ekoetiketa nuk mund të përdoret si një markë tregtare apo pjesë e saj.

26. Ndalohet:

a) përdorimi i ekoetiketës apo i një logoje të ngjashme me të me qëllim keqinformimin e konsumatorëve;

b) mosrespektimi i kushteve dhe afatit të përcaktuar në ekoetiketë;

c) vazhdimi i përdorimit të ekoetiketës pasi është hequr nga ministri.

27. Prodhuesi, i cili është i pajisur me ekoetiketën “EU ecolabel”, sipas normativës së Bashkimit Evropian, nuk i nënshtrohet procedurave të këtij vendimi për pajisjen me ekoetiketë.

#### IV. KUNDËRVAJTJET DHE HYRJA NË FUQI

1. Mospërmbushja e kërkesave të këtij vendimi përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas shkronjës “g”, të pikës 1, të nenit 69, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.

2. Udhëzimet e përbashkëta, të përmendura në pikën 4, kreu II, të këtij vendimi, miratohen brenda 5 viteve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Komisioni Shtetëror për Dhënie të Ekoetiketës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 3 (tre) muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

#### SHTOJCA 1

#### LISTA E PRODUKTEVE DHE GRUP PRODUKTEVE PËR TË CILAT MUND TË JEPET EKOETIKETA

1. Produkte të higjienës dhe përkujdesjes së pamjes (bukurisë)

- sapunë, shampo, balsam flokësh
- peceta higjienike thithëse (absorbuese)

2. Produkte të pastrimit

Pastrues sanitarë dhe pastrues për të gjitha qëllimet

- Detergjentë për makinat larëse
- Detergjentë për makina larëse automatike industriale dhe institucionale
- Detergjentë për larje me dorë
- Detergjentë për lavanderi
- Detergjentë për lavanderi industriale dhe institucionale

3. Veshje dhe tekstile

- Tekstile
- Këpucë dhe të gjitha veshjet për këmbët

4. Produktet që vetëpërdoren (*Do it yourself*)



- Lustrues (vernice) dhe bojëra
- 5. Pajisje elektronike
  - Pajisjet e imazhit
  - Kompjuter personal (laptop)
  - Kompjuter të vegjël (notebook)
  - Televizor
- 6. Mbulesa
  - Veshje druri e dyshemesë (parkete)
  - Veshje
  - Mbulesë tekstile e dyshemesë
- 7. Mobilje
  - Mobilje druri
- 8. Produkte kopshtarie
- 9. Pajisje shtëpiake
  - Burimet e dritës (llambat)
  - Pajisjet e nxehtësisë
  - Pajisjet ngrohëse me ujë
- 10. Lubrifikantë
- 11. Artikuj të tjerë shtëpiake
  - Dyshek krevati
  - Pajisjet hidrosanitare
- 12. Produktet e letrës
  - Letër e konvertuar
  - Letër gazete
  - Letër printuar
  - Letër kopjimi dhe grafike
  - Letër higjienike
- 13. Akomodim pushimesh
  - Shërbime kampingu
  - Shërbime për akomodimin e turistëve
- 14. Ndërtesat e zyrave
- 15. Shërbimet e pastrimit

### VENDIM

Nr. 221, datë 11.3.2015

## **PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “TIRANË – NDROQ – PLEPA (LOTI 7)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë – Ndroq – Plepa (loti 7)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë “arë”, ”truall” dhe “objekt”, me vlerë të përgjithshme prej 20 541 534 (njëzet milionë e pesëqind e dyzet e një mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë”, 2 963 (dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre) m<sup>2</sup>, me vlerë 2 663 737 (dy milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë;

b) “truall”, 1 910 (një mijë e nëntëqind e dhjetë) m<sup>2</sup>, me vlerë 15 918 000 (pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë;

c) “objekt”, me vlerë 1 959 796.8 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë tetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “arë”, “truall” dhe “objekt”, prej 20 541 534 (njëzet milionë e pesëqind e dyzet e një mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekësh të përballohet nga “Buxheti i vitit 2015”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësimet”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të



Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet

procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
SEKTORI TOPOLOGJIK

Lista e pasurive që shpronësohen për efekt të ndërtimit të segmentit rrugor  
Tiranë-Ndroq-Plepa Loti 7 (Nyja Plepa)

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr.Pas	Lloji i Pasurisë							Shënime		
						ARË			TRUALL			Objekte		Totali( Lekë)	
						Sip.	Cmimi	Vlera	Sip.	Cmimi	Vlera	Lloji			Vlera
<b>Fshati Shkallnur Komuna Rashbull</b>															
1	Rexhep		Tusha	3385	203/4				90	7000	630000		630,000	Konfirmim ZVRPP	
2	Naim		Alihysa	3385	209/2	41	899	36,859					36,859	Konfirmim ZVRPP	
3	Arben		Tafili	3385	206/2	411	899	369,489					369,489	Konfirmim ZVRPP	
4	Mustafa		Tafili	3385	206/1	1258	899	1,130,942					1,130,942	Konfirmim ZVRPP	
5	Enkelejda		Tafili	3385	206/4	272	899	244,528					244,528	Konfirmim ZVRPP	
6	Vahidije		Tafili	3385	206/5	314	899	282,286					282,286	Konfirmim ZVRPP	
7	Jonuz		Tafili	3385	206/6	667	899	599,633					599,633	Konfirmim ZVRPP	
<b>Qyteti Durrës</b>															
8	Ylvi		Muco	8518	50/84				192	8400	1612800	Shesh+mur	1959796.8	3572596.8	Konfirmim ZVRPP
9	Ylvi		Muco+Bp	8518	50/25				23	8400	193200			193200	Konfirmim ZVRPP
10	Familja Ismaili			8518	50/38				200	8400	1680000			1680000	Konfirmim ZVRPP
11	Haxhi		Nexha	8518	50/61				100	8400	840000			840000	Konfirmim ZVRPP
12	Zenepe		Prezja	8518	50/50				18	8400	151200			151200	Konfirmim ZVRPP
13	Bejte		Keci+Bp	8518	50/79				460	8400	3864000			3864000	Konfirmim ZVRPP
14	Maria		Polena+Bp	8518	53/57				134	8400	1125600			1125600	Konfirmim ZVRPP
15	Indrit		Nuredini	8518	53/59				262	8400	2200800			2200800	Konfirmim ZVRPP
16	Emine		Xhafa+Bp	8518	53/67				118	8400	991200			991200	Konfirmim ZVRPP
17	Emine		Xhafa+Bp	8518	53/68				43	8400	361200			361200	Konfirmim ZVRPP
18	Fatime		Xhafa+Bp	8518	54/58				195	8400	1638000			1638000	Konfirmim ZVRPP
19	Idriz	Demir	Xhafa	8518	54/55				65	8400	546000			546000	Konfirmim ZVRPP
20	Avni		Mehmeti	8518	54/64				10	8400	84000			84000	Konfirmim ZVRPP
<b>SHUMA</b>						<b>2963</b>		<b>2,663,737</b>	<b>1910</b>		<b>15918000</b>		<b>1959796.8</b>	<b>20,541,534</b>	

**VENDIM****Nr. 222, datë 11.3.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË  
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI  
I SEGMENTIT “QAFËTHANË – LIN  
- POGRADEC (LOTI 2)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qafëthanë – Lin – Pogradec (loti 2)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë “arë”, “truall” dhe “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 56 030 884 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e tridhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë”, me sipërfaqe 36 460 (tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) m<sup>2</sup> me vlerë 7 292 000 (shtatë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë;

b) “truall”, me sipërfaqe 8 003 (tetë mijë e tre) m<sup>2</sup>, me vlerë 32 375 734 (tridhjetë e dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) lekë;

c) “objekte”, me vlerë 16 363 150 (gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “arë”, “truall” dhe “objekte”, prej 56 030 884 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e tridhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga “Buxheti i vitit 2015”, miratuar

për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësim”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi Rama**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR  
"QAFË THANË - LIN - POGRADEC"

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastr.	Numri Paturisë	Sip. Totale	TOKË ARË			TOKË TRUALL			VLERA TOTALE (LEKE)	Shënime
							Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera lekë	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera lekë		
	<b>FSHATI LIN Z.K.2457</b>													
1	Bajram	Resul	Avdullari	2457	113/5	300	95	200	19000		2911		19000	Konfirmim ZVRPP
2	Niazi	Resul	Avdullari	2457	113/6	300	95	200	19000		2911		19000	Konfirmim ZVRPP
3	Vait	Resul	Avdullari	2457	113/7	1000	300	200	60000		2911		60000	Konfirmim ZVRPP
4	Mifri	Risto	Marko	2457	231/7	530	11	200	2200		2911		2200	Konfirmim ZVRPP
5	Tomorr	Xhelo	Turka	2457	231/6	375	30	200	6000		2911		6000	Konfirmim ZVRPP
6	Pali	Ustian	Bice	2457	231/5	400	41	200	8200		2911		8200	Konfirmim ZVRPP
7	Ndrio	Nestor	Shegami	2457	231/4	250	23	200	4600		2911		4600	Konfirmim ZVRPP
8	Kadife	Sefedin	Turka etj	2457	231/3	375	26	200	5200		2911		5200	Konfirmim ZVRPP
9	Naxhi	Vesel	Turka etj	2457	231/25	240	85	200	17000		2911		17000	Konfirmim ZVRPP
10	Naxhi	Vesel	Turka	2457	231/23	320	140	200	28000		2911		28000	Konfirmim ZVRPP
11	Gjergji	Spiro	Bice	2457	277/4	1125	204	200	40800		2911		40800	Konfirmim ZVRPP
12	Ligor	Liazi	Bice	2457	277/3	1494	414	200	82800		2911		82800	Konfirmim ZVRPP
13	Andon	Risto	Bale	2457	277/2	1437	486	200	97200		2911		97200	Konfirmim ZVRPP
14	Ilmi	Ramadan	Kreka	2457	277/8	1100	601	200	120200		2911		120200	Konfirmim ZVRPP
15	Gavril	Jovan	Bale	2457	275/49	2635	4	200	800		2911		800	Konfirmim ZVRPP
16	Gjorgji	Risto	Shegami	2457	275/50	2040	40	200	8000		2911		8000	Konfirmim ZVRPP
17	Letferke	Marko	Shegami	2457	275/51	1000	60	200	12000		2911		12000	Konfirmim ZVRPP
18	Pasko	Thomas	Bice	2457	275/52	2100	95	200	19000		2911		19000	Konfirmim ZVRPP





19	Vangjel	Bendo	Gjoja	2457	275/53	2100	117	200	23400	2911	23400	Konfirmim ZVRPP
20	Gjergji	Zafir	Bice	2457	275/54	2099	143	200	28600	2911	28600	Konfirmim ZVRPP
21	Slave	Koli	Propishtiti	2457	275/55	2100	166	200	33200	2911	33200	Konfirmim ZVRPP
22	Dhori	Thanas	Bice	2457	275/56	2200	171	200	34200	2911	34200	Konfirmim ZVRPP
23	Kreste	Andon	Jorgo	2457	275/57	2000	78	200	15600	2911	15600	Konfirmim ZVRPP
24	Bashkim	Maliq	Bashalli	2457	276/1	2038	125	200	25000	2911	25000	Konfirmim ZVRPP
25	Shpetim	Maliq	Bashalli	2457	276/2	2038	118	200	23600	2911	23600	Konfirmim ZVRPP
26	Artan	Hamdi	Hamati	2457	276/34	1000	200	200	40000	2911	40000	Konfirmim ZVRPP
27	Beqir	Batfjar	Korance	2457	276/5	1979	90	200	18000	2911	18000	Konfirmim ZVRPP
28	Dylber	Sadush	Bashalli	2457	276/6	1420	60	200	12000	2911	12000	Konfirmim ZVRPP
29	Egeqrem	Dylber	Bashalli	2457	276/7	1600	58	200	11600	2911	11600	Konfirmim ZVRPP
30	Haki		Korance	2457	276/8	2069	54	200	10800	2911	10800	Konfirmim ZVRPP
31	Veseli	Bajram	Turka	2457	276/9	2080	41	200	8200	2911	8200	Konfirmim ZVRPP
32	Ibrahim	Haki	Sulollari	2457	276/10	2060	33	200	6600	2911	6600	Konfirmim ZVRPP
33	Ijaz	Shaban	Sulollari	2457	276/11	2100	17	200	3400	2911	3400	Konfirmim ZVRPP
34	Sulejman	Jakup	Sulollari	2457	276/12	2150	7	200	1400	2911	1400	Konfirmim ZVRPP
35	Resul	Dalip	Avdullari	2457	281/1	350	110	200	22000	2911	22000	Certifikatë pronësie
36	Bashkëpronarët	Shegani		2457	281/4	270	130	200	26000	2911	26000	Certifikatë pronësie
37	Ekurani	Metali	Bashalli	2457	299/32	982	2	200	400	2911	400	Konfirmim ZVRPP
38	Qamil	Ilaet	Avdullari	2457	299/31	1965	10	200	2000	2911	2000	Konfirmim ZVRPP
39	Kristaq	Kume	Anastasi	2457	299/29	2030	26	200	5200	2911	5200	Konfirmim ZVRPP
40	Dimitraq	Kume	Anastasi	2457	299/28	2140	36	200	7200	2911	7200	Konfirmim ZVRPP
41	Pejazit		Avdullari	2457	299/27	1950	37	200	7400	2911	7400	Konfirmim ZVRPP
42	Qemal	Bilal	Avdullari	2457	299/25	1938	17	200	3400	2911	3400	Konfirmim ZVRPP
43	Petrit	Demir	Bashalli	2457	299/24	1667	21	200	4200	2911	4200	Konfirmim ZVRPP
